

# Raport Vjetor i Pasqyrave Financiare 2016



## Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar

Raporti vjetor 2016, për performancën e ndërmarrjeve të  
mëdha në Kosovë

Këshilli i Kosovës për  
Raportim Financiar

Tring Smajli, Prishtinë, 10000

038 20034625

038 20034627

3/10/2016

## **Përmbajtja**

1. Hyrje.
2. Indikatorë bazik të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë.
3. Rezultatet financiare të shoqërive të mëdha tregtare sipas formës së pronësisë.

## - Hyrje

Bazuar në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nr. 04/L-014, pasqyrat financiare të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë duhet të auditohen në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, nga firmat e auditimit të licencuara nga KKRF-ja. Njëkohësisht konform nenit 11 të Ligjit obligohen shoqëritë tregtare të mëdha që të dorëzojnë dhe të publikojnë pasqyrat financiare pranë Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF). Përderisa pasqyrat financiare të shoqërive tregtare të mëdha duhet të përgatiten konform standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

Pasqyrat financiare të dorëzuara pranë KKRF-së janë pjesë përbërëse e regjistrit të pasqyrave financiare vjetore në nivel të vendit. Regjistri vjetor i pasqyrave financiare shërben si burim qendror i informatave të aktivitetit të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë dhe pozitës së tyre financiare. Qëllimi kryesor i krijimit të një regjistri vjetor të pasqyrave financiare, është ngritja e transparencës financiare të shoqërive tregtare të mëdha të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e vendit.

Prandaj formimi i një regjistri të këtillë është një hap drejt harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me atë të vendeve të Bashkimit Evropian. Afati për dorëzimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare të mëdha është data 30 prill i vitit vijues.

Numri i shoqërive tregtare të mëdha të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare pranë KKRF-së për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2014 është 221, (gjithsej total janë dorëzuar 261 raporte financiare duke përfshirë këtu disa subjekte ekonomike që i përkasin edhe kategorisë 1.2 të ligjit) duke përjashtuar bankat dhe shoqëritë e sigurimit të cilat nuk janë subjekt i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Ndërsa, shoqëritë tregtare të mëdha të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2015 është 248, (gjithsej total janë dorëzuar 283 raporte financiare duke përfshirë këtu disa subjekte ekonomike që i përkasin edhe kategorisë 1.2 të ligjit) duke përjashtuar bankat dhe shoqëritë e sigurimit të cilat nuk janë subjekt i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.


## Indikatorë bazik të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë

Tabela 1. Rezultatet Financiare të Shoqërive Tregtare në Kosovë

Përshkrimi	Në Euro (*000) 2014	Në Euro (*000) 2015	2014/2015 Indeksi
Asetet	3,720,316	4,200,763	1.13
Të hyrat	3,422,247	3,960,765	1.16
Fitimi para-tatimit	171,369	208,012	1.21
Humbja para tatimit	-29,106	-36,758	1.26
Tatimi në fitim	16,446	20,136	1.22
Fitimi pas tatimit	184,174	220,486	1.20
Humbja pas tatimit	-29,251	-36,360	1.24
Nr. i ndërmarrjeve	221	248	1.12
Të punësuarit	44,101	49,025	1.11


Vlera e aseteve të shoqërive tregtare të mëdha në vitin 2014 ishte Euro 3.7 miliardë, ndërsa në vitin 2015 vlera e aseteve të shoqërive tregtare të mëdha arrijnë shumën prej Euro 4.2 miliardë, më e lartë krahas vitit 2014 për Euro 480 milionë, gjegjësisht 13%.

Grafikun 1: Lëvizja e aseteve e shoqërive tregtare të mëdha viti 2014/2015




Në vitin 2014 shoqëritë tregtare në Kosovë kanë realizuar të hyra në vlerë prej Euro 3.4 miliardë, në vitin 2015 të hyrat e realizuara arrijnë në Euro 3.9 miliardë, krahasuar me vitin 2014 ka shënuar një rritje prej Euro 538 milionë, gjegjësisht 16%.

Grafikun 2: Lëvizja e të hyrave të shoqërive tregtare të mëdha viti 2014/2015



Fitimi para-tatimit për këtë kategori të shoqërive tregtare në vitin 2014 ishte Euro 171.3 milionë, ndërsa në vitin 2015 fitimi para tatimit është Euro 208.0 milionë, fitimi para-tatimit ka shënuar ngritje prej Euro 36.6 milionë apo 21.38% krahasuar me vitin paraprak. Fitimi pas tatimit në vitin 2014 ishte në vlerë prej Euro 184.1 milionë, apo 19.71% më i ulët krahas vitit 2015 kur fitimi pas tatimit në 2015 është në Euro 220.4 milionë.


Grafikun 3: Fitimi para tatimit të shoqërive tregtare të mëdha viti 2014/2015



Po ashtu në vitin 2015, 54 shoqëri tregtare përfunduan vitin financiar me humbje pas tatimit, në vlerë prej Euro 36.3 milionë, ndërsa në vitin 2014, 30 shoqëri tregtare përfunduan vitin financiar me humbje në vlerë prej Euro 29.2 milionë. Numri i shoqërive tregtare të cilat kanë operuar me humbje ka pësuar një rritje (për 24 shoqëri tregtare) krahas vitit paraprak, përdërisa humbja ka shënuar një ulje të vogël në vlerë prej Euro 7.1 milionë .


Tatimi në fitim për shoqëritë tregtare të mëdha për vitin 2015 është në vlerë prej Euro 20.13 milionë, ndërsa në vitin 2014 ishte në vlerë prej Euro 16.44 milionë.

Grafikun 4: Tatimi në fitim të shoqërive tregtare të mëdha viti 2014/2014



Vlen të theksohet roli i rëndësishëm i shoqërive tregtare të mëdha në tregun e punësimit në Kosovë, duke punësuar total 49,025 punonjës në vitin 2015, ndërsa në vitin 2014 total të punësuar ishin 44,101 në këtë mënyrë numri i të punësuarve në këtë kategori të ndërmarrjeve është rritur për 11.16% krahas vitit 2014.

Grafikun 5: Lëvizja e numrit të të punësuarve në shoqëri tregtare të mëdha viti 2014/2015



## Rezultatet financiare të shoqërive të mëdha tregtare sipas formës së pronësisë

Në dhjetëvjeçarin e fundit në ekonominë e Kosovës, ndikim të veçantë ka shënuar edhe procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike/shoqërore, ku është shënuar një ngritje e vogël në sektorin privat. Trendët e lartpërmendura po ashtu janë reflektuar edhe në rezultatet financiare të prezantuara në tabelat në vijim, për sektorin publik dhe atë privat.

Tabela 2: Lëvizjet e aseteve të shoqërive të mëdha tregtare sipas llojit të pronësisë

Viti	Sektori Publik në Euro ('000)	Sektori Privat në Euro ('000)	Total
2014	1,433,044	2,287,272	3,720,316
2015	1,343,820	2,856,943	4,200,763
Indeksi	0.94	1.25	1.13

Shikuar nga aspekti i aseteve të shoqërive tregtare sektori publik (28 ndërmarrje publike) ka pasur një ulje për 6.22% krahas vitit 2014. Njëkohësisht vlen të theksohet rritja e aseteve në sektorin privat (220 ndërmarrje private), rritje kjo e cila arriti në 24.90% gjatë vitit 2015, krahas vitit paraprak (2014).

Grafikun 6: Lëvizjet e aseteve të shoqërive të mëdha tregtare sipas llojit të pronësisë






Tabela 3: Lëvizjet e të hyrave të shoqërive tregtare sipas llojit të pronësisë

Viti	Sektori Publik në Euro ('000)	Sektori Privat në Euro('000)	Total
2014	658,139	2,764,108	3,422,247
2015	379,732	3,581,033	3,960,765
Indeksi	0.58	1.30	1.16

Ngjashëm me trendin dominues të aseteve të shoqërive të mëdha nga sektori privat, të hyrat në sektorin privat në relacion me të hyrat e realizuara në sektorin publik vazhdojnë të kenë një rol dominues. Megjithatë të hyrat në këtë sektor gjatë viti 2015 kanë shënuar një rritje për 29.55%, krahas të hyrave të vitit paraprak 2014. Përderisa trendi i realizimit të të hyrave në sektorin publik gjatë vitit 2015 ka shënuar ulje prej 42.30% krahas vitit paraprak.

Grafikun 7: Lëvizjet e të hyrave të shoqërive tregtare sipas llojit të pronësisë





Tabela 4: Numri i të punësuarit sipas sektorit

Viti	sektori publik	sektori privat	Total
2014	19,502	24,599	44,101
2015	15,655	33,370	49,025
Indeksi	0.80	1.36	1.11

Krahasuar me vitin paraprak në vitin 2015 numri i të punësuarve është zvogëluar për 3847 vende pune në sektorin publik, ndërsa ka shënuar rritje për 8771 vende për sektorin privat. Përderisa në vitin 2014 një punëtor ka gjeneruar diku prej Euro 112 mijë në vit, në vitin 2015 një punëtor në këtë sektorë ka gjeneruar Euro 107mijë, pasi që numri i të punësuarve në këtë sektorë ka shënuar një ngritje prej 35.65%.

Vlen të theksohet që numri total i të punësuarve në vitin 2015 ishte për 4924 vende pune më i lartë krahas vitit paraprak.

Grafikun 8: Numri i të punësuarit sipas sektorit



Ndërsa, sa i përket opinionit të auditorit lidhur me auditimin e kryer në kompanitë ekonomike nga 248 raportime financiare të audituara, 142 janë me opinion të kualifikuar dhe 106 me opinion të pakualifikuar.

Të gjitha shënimet e prezantuara më lartë janë të përgatitura bazuar në pasqyrat e audituara dhe të dorëzuara në KKRF, për shoqëri tregtare të mëdha, siç është e definuar në bazë të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe shënimeve shtesë të ofruar nga shoqëritë e lartpërmendura për qëllim të përgatitjes së regjistrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Shënimet të cilat do të jenë të publikuara në web faqen e KKRF-së, me qëllim të rritjes së transparencës së raportimit financiar dhe ofrimit të shënimeve publikut të gjerë për këtë kategori të ndërmarrjeve të cilat sipas madhësisë së tyre i takojnë grupit të ndërmarrjeve me interes publik .

-----\*\*\*-----